



Data: 16.10.2023

Numri i vrojtimit të lejes:

07Nr. 815/350-57207

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis

Në bazë të nenit 21 të LPH nr.04/L-174 datë 31.07.2013, nenit 18 të LN nr.04/L-110 datë 31.05.2012, neni 13 paragrafi 4 pika 2 i UA-06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për Kushte ndërtimore, Leje ndërtimore dhe Leje rërimi për kategorinë e I dhe të II të ndërtimeve, UA Nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor datë 09.06.2017, Hartës Zonale të Komunës së Suharekës 2022-2030 01Nr.016-69078 datë 28.10.2022, si dhe neneve 44,47,48 dhe 125 të LPPA nr.05/L-031, DUP në Suharekë lëshon këtë:

**AKTVENDIM
(MBI LEJE NDËRTIMORE)**

Kjo leje ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	Luljete Shala	Email :	/
Adresa:	Rr." Pika e Ushtrisë së UÇK-së" Nepërbisht Suharekë	Kërkesa Bazë:	Aplikim për Leje ndërtimore: 07Nr.350-57207 datë: 28.08.2023

Emri i Projektit:	Depo për ruajtjen e pemëve dhe perimeve P+0
Emri i Projektuesit:	N.SH "Smart Architecture "
Adresa:	Prizren
Email:

Për punët ndërtimore në vijim: NDËRTIM I RI, KATEGORIA I –Leje e përkohshme			
Adresa: Rr." Pika e Ushtrisë së UÇK-së" Nepërbisht, Komuna Suharekë			
Zona(t) Kadastrale: Nepërbisht	Nr. i parcelës kadastrale:	GPS Koordinatat e objektit:	
Çertifikata me Nr.ref.3886/2023 datë 11.09.2023 pronë e Luljete Shala dhe Çertifikata me Nr.ref.3886/2023 datë 11.09.2023 pronë e Agron Isa Shalës.	00560-0,	Y= 7478386.658	X=4689072.318
	00561-0	Y= 7478398.455	X=4689074.515
		Y= 7478402.117	X=4689054.853
		Y= 7478390.320	X=4689052.656

Lloji i ndërtimit të propozuar:			
Depo për ruajtjen e pemëve dhe perimeve			
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:			
Kategoria I			
Gabariti:	240.0m ²	Katshmëria:	P+0

Vija rregullative:	Sipas Kushteve Ndërtimore : 07Nr.606/350-14779, datë 21.07.2023.	Vija ndërtimore:	Sipas Kushteve Ndërtimore : 07Nr.606/350-14779, datë 21.07.2023.
---------------------------	--	-------------------------	--

Përshkrimi

Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore të përhershme **Luljete Shala** nga Nepërbishti Komuna Suharekë i lejohet ndërtimi i objektit të përhershëm me destinim Depo për ruajtjen e pemëve dhe perimeve me etazhitet P+0 .

Lokacioni i objektit është në kuadër të Hartës Zonale të Komunës 2022- 2030 01Nr.016-69078 datë 28.10.2022, ku sipas gjendjes së planifikuar në parcelën kadastrale 00560-0 dhe 00561-0, është Zonë Banimore-ZB2 me shfrytëzim të lejuar të veçant edhe për infrastrukturë bujqësore-Objekte për grumbullimin dhe trajtimin e produkteve Bujqësore (veprimtari ndihmëse pas vjeljes së pemëve), sipas Projektit kryesor hartuar nga: N.Sh "Smart Architecture" Prizren.

Objekti ka karakter të perkohshëm në afat prej 10 viteve (dhjetë viteve) me mundësi vazhdimi konform kontratës mbi dhënjën e paluajtshmërisë në shfrytëzim me kompensim Nr.LRP.7802/, Nr.Ref.2149/2023; me etazhitet P+0. Ndërtimi i objektit të bëhet konform projektit të pranuar nga DUPM e të nënshkruar me numër të Lejes Ndërtimore. Objekti është lejuar të ndërtohet me sipërfaqe në përdhese 240.0 m².

Kjo leje ndërtimore lëshohet në bazë të aplikacionit dhe informatave mbështetëse. Ndërtimi të bëhet në përputhje me dokumentet e aprovuara ndërtimore. Çfarëdo ndryshimi i projektit duhet të aprovohet nga hartuesi i projektit dhe nga ky organ.

Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Puna në ndërtim duhet të fillojë brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin.
- Të vendos tabelën informuese në vendndërtim me informata e mëposhtme:
 - Informata mbi Lejen Ndërtimore.
 - Informata mbi Projektuesin.
 - Informata mbi Kontraktuesin.
 - Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit.
- Duhet të siguroheni se kontraktuesi në vendndërtim i posedon dokumentet e mëposhtme:
 - Një kopje të kësaj leje ndërtimore.
 - Nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë, një kopje e kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit.
 - Një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të "APROVUAR" nga organi kompetent.
 - Projektin Kryesor me të gjitha fazat për nevoja të realizimit të ndërtimit.
 - Dokumentacioni që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, Kodin dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit.
 - Librin dhe ditarin e ndërtimit, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur.
 - Protokolet e miratuara të nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit.
 - Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore.

Duhet të njoftojë organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj dhe akte nënligjore dhe Kod. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore. Në rast të mos respektimit të Lejes së ndërtimit si dhe në çdo parregullsi që haset në teren inspektori përgjegjës duhet të njoftoj me shkrim organin kompetent në mënyrë që të vepohet në përputhje me dispozitat ligjore. Nëse gjatë punimeve haset në elemente arkeologjike, Investitori është i obliguar ti ndërpresë punimet dhe të njoftoj organet komunale.

- Të njoftojë organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga Projektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuara nga projektuesi përveç në rastet kur:
 - o Ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret në fuqi.
 - o Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një(0.1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore.
 - o Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, kodet dhe rregulloret teknike në fuqi.
- Obligohet investitori që gjatë gërmimit dhe ndërtimit të objektit të bëjë pastrimin e materialit të panevojshëm për punë dhe se të njëjtin ta transportojë në deponinë për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore, në lokacionin e përcaktuar nga Kuvendi i Komunal.
- Pas përfundimit të punëve ndërtimore dhe pranimit teknik të të gjitha fazave, të aplikojë për çertifikatë të përdorimit në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore.

A r s y e t i m

Aplikuesja **Luljete Shala** nga Nepërbishti Komuna Suharekë, përmes kërkesës 07Nr.350/57207 datë: 28.08.2023, ka kërkuar nga organi kompetent lëshimin e Lejes Ndërtimore për ndërtim të objektit me destinim Depo për ruajtjen e pemëve dhe perimeve me etazhitet P+0 , sipas projektit të bashkangjitur.

Kjo leje ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Aktvendimin mbi Kushtet Ndërtimore 07Nr.606/350-14779 datë 21.07.2023 (kopje)
- Pëlqim për largimin e mbeturinave Nr.248/23, datës: 04.09.2023 lëshuar nga Kompania Regjionale për Mbeturina "ECO-REGJIONI"- Prizren, Njësia operative Suharekë.
- Vertetimin e Ujësllësit dhe Kanalizimit-Hidroregjioni Jugor Prizren Nr.190 datë: 10.08.2023.
- Pëlqim për kushtet e sigurisë në komunikacion rrugor-nga Inspektori i Komunikacionit Rrugor 09Nr.319 datë: 03.08.2023.
- Pëlqim parimor nga KEDS-SH.A, Nr.639, datë: 21.08.2023.
- Pëlqim në dokumentacion teknik mbi masat e parapara për mbrojtje nga zjarri Nr.03/03-114 datë 14.09.2023.
- Kordinatat e vendosjes së objektit sipas skicës së terrenit me numër të lëndës 129-309/2023 të datës 02.10.2023 të punuar nga gjeodeti i licensuar Luan Abazi me Numër të licencës 129.
- Tri kopje të projektit zbatues dhe kopje elektronike
- Kopje e planit dhe çertifikata e pronësisë
- Vërtetimin e tatimit në Pronë
- Kopje e dokumentit Identifikues
- Njoftimin për pagesë (taksa administrative 576.0€) 07Nr.811/350-57297 datë 13 .10.2023, parashtruesit të kërkesës i është caktuar lartësia e ``pagesës për leje ndërtimore në shumën prej 576.0€ dhe se për

Faqe4nga5

pagesën e kryer janë sjellë dëshmia nga Banka për Biznes -Therandë me datë 13.10.2023, sipas faturës komunale nr.001203 të datës 13.10.2023.

Ky organ përmes shërbimit të vet profesional pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumenteve tjera përcjellëse, bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, UA Nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor datë 09.06.2017, Hartës Zonale të Komunës së Suharekës 2022- 2030 01Nr.016-69078 datë 28.10.2022, ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejës Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.


Udhëzim juridik: Kundër kësaj Leje Ndërtimore pala e pakënaqur mund t'i paraqitet ankesë MMPHI në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e dorëzimit përmes këtij Organi.

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis – Komuna Suharekë
Numri i vrojtimit i lejes 07Nr. 815/350-57297 datë: 16 .10.2023

Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Inspektoratit të Komunës;
- DSHPJK;
- Dosjes së DUP-së

Drejtori i Drejtorisë:
Visar KUÇI



Faqe 5 nga 5